



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Obiliqit
Opština Obiliq – Municipality of Obilic



Datë/Data/Date	16.09.2025
Nga/Od/From:	Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2026-2028
Tema/Subjekat/Subject:	Raporti për mbajtjen e dëgjimeve publike Buxhetore 2026-2028

Raporti për mbajtjen e dëgjimeve publike buxhetore për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Obiliqit për vitin 2026

Hyrje

Përmes këtij Raporti përmbledhës të Konsultimeve Publike synohet që të dokumentohen të gjitha format e konsultimit publik që i kanë paraparirë përpilimit/draftimit të projekt-propozimit të buxhetit nga ana e ekzekutivit të komunës së Obiliqit. Kjo nënkupton që përfshihen takimet publike obligative të mbajtura në gjashtëmujorin e parë nga ana e Kryetarit, format të konsultimit publik në të shkruar, dëgjimet buxhetore për KAB e po ashtu ato për buxhet vjetor, etj. Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna 04/2023, përcaktohen rregullat që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve përfaqësuese në vendimmarrje lokale, transparencën dhe llogaridhënien e organeve të komunës, gjithashtu përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore në komunë si dhe obligimet e komunave për të siguruar qasjen nëpërmjet teleprezencës dhe teknologjisë digjitale për të garantuar transmetimin në distancë dhe monitorimin nga autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe qytetarët. Sipas këtij Udhëzimi, Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimmarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e: 1.1 Takimeve publike; 1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave; 1.3 Takime konsultative me qytetarë; 1.4 Dëgjime buxhetore. Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Obiliqit (K.OB) 01-51-10, si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2024 të Hapur në Komuna dhe Rregullorës për Transparencë Komunale në Komunën e Obiliqit, komuna e Obiliqit ka organizuar dëgjimet buxhetore për planifikimin buxhetor për vitin 2026. Ky raport përmbledh rrjedhën e këtyre dëgjimeve të mbajtura me qytetarë dhe grupe të interesit në lokalitete të ndryshme të komunës, duke përfshirë informacion mbi pjesëmarrjen, temat e ngritura, kërkesat e paraqitura dhe vendimet e marra nga grupi punues.

Raporti ka për qëllim të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie në procesin e përgatitjes së buxhetit për vitin 2026 dhe shërben si dokument referues për institucionet komunale dhe publikun e gjerë

Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe

dokumenteve lokale. Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt- propozimit gjatë mbajtjes së konsultimit publik mbledh komentet dhe përgatit raport për rezultatet e konsultimit publik.

Neni 60 Përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore nga ZKF dhe Kryetari i Komunës, ZKF i komunës duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t'i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi (i) tavanet e shpenzimeve të aplikueshme për departamentin përkatës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime mbi këto tavane për dy (2) vitet e ardhshme fiskale, dhe (ii) metodologjinë dhe formularët që duhet të shfrytëzohen nga departamenti përkatës gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal. Qarkorja buxhetore duhet të përfshijë: a) procedurat që duhet përdorur nga departamenti gjatë përgatitjes së propozim buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore; b) të dhënat të cilat duhet të parashtrohen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore; c) detale mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore; dhe d) afatin e fundit deri në të cilin departamenti duhet të përfundojë dhe t'i dorëzojë ZKF-së propozim buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

Raporti përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor dhe është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare. Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.


Të gjithë emrat dhe fotografitë e qytetarëve që janë përdorur gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë me pëlqimin e tyre. Grupi punues ka vendosur që të redaktoj dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë. Ky raport në ditën e miratimit është bërë publik dhe i është dorëzuar Kryetarit të komunës dhe Asamblesë së Komunës së Obiliqit. Në faqen e komunës në kuadër të këtij procesi janë publikuar, kalendari i dëgjimeve, plani i punës, ftesat për pjesëmarrje, raportet e shkurta nga dëgjimet, procesverbalet nga dëgjimet dhe materialet e tjera promovuese të cilat janë të listuara brenda këtij dokumenti.

Ecuria e procesit të dëgjimeve publike

Procesi i organizimit të dëgjimeve publike për përgatitjen e projekt-buxhetit të Komunës së Obiliqit për vitin 2026 është zhvilluar në disa faza të njëpasnjëshme që synojnë të sigurojnë përfshirje, transparencë dhe konsultim të gjerë me qytetarët dhe grupet e interesit. Fillimisht, është themeluar grupi punues përgjegjës për planifikimin dhe koordinimin e të gjithë procesit. Më pas, janë përgatitur plani dhe kalendari i konsultimeve, të cilat janë publikuar për publikun në uebfaqen dhe platformat zyrtare të komunës. Njoftimet për dëgjimet janë shpërndarë brenda afateve ligjore, ndërsa procesverbalet nga dëgjimet e mbajtura janë dokumentuar dhe arkivuar. Komuna ka zhvilluar gjithashtu konsultime të drejtpërdrejta me këshillat e fshatrave dhe bashkësitë lokale, ku janë kërkuar lista me prioritete, një pjesë e të cilave janë përfshirë në projekt-buxhet. Në kuadër të transparencës dhe komunikimit të rregullt, janë përfshirë edhe takimet javore të Kryetarit të Komunës me qytetarë, si dhe kërkesat e pranuar me shkrim përmes e-mailit apo kanaleve të tjera, të gjitha të trajtuara nga grupi punues sipas kritereve të përcaktuara.

Buxheti i Komunës së Obiliqit sipas Qarkores **2026/02**, të datës 21.08.2026 me nr.Protokollit:06/4/40-2592/2025 për vitin 2026 është parashikuar në vlerën prej 16,281,831.00 euro. Buxheti është i ndarë në kategori si: Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime Subvencione dhe Transfere Shpenzime Komunale si dhe Investime Kapitale.

Paga dhe meditje	6,533,243.00	40	%
Mallra dhe sherbime	2,000,000.00	12	%
Shpenzime Komunale	320,000.00	2	%
Subvencione	1,100,000.00	7	%
Investime Kapitale	6,328,588.00	39	%
Gjithsejte	16,281,831.00	100.00	%



Më poshtë mund të gjeni përmbledhjen e ecursisë së procesit në formë tabelare, bashk me datat dhe vegëzat për secilën fazë të këtij procesi

Përmbajtja	Përshkrimi	Shtesë / Link
Formimi i Grupit Punues	Data e formimit të grupit që ka planifikuar dhe organizuar konsultimet publike për projekt-buxhetin 2026.	Më 05.03.2025 është miratuar vendimi nr. 02-020-01-6120-25 për themelimin e Grupit Punues përgjegjës për dëgjimet buxhetore në Komunën e Obiliqit, me përbërje prej 10 anëtarësh. Vendimi është plotësuar dhe ndryshuar më 10.07.2025 me nr. 02-020-01-18713-25, duke e rritur numrin e anëtarëve të grupit nga 10 në 13.
Përgatitja e Planit dhe Kalendari i Konsultimeve	Kalendari për dëgjime buxhetore me pjesëmarrje është publikuar më 10.07.2025 dhe ka përfshirë 18 dëgjime buxhetore. Ky kalendar është postuar në ueb-faqen zyrtare të komunës, në faqen e Facebook-ut dhe në grupin Viber ku komuna ka databazën e qytetarëve. Një tjetër kalendar është publikuar më 07.08.2025 për dëgjime buxhetore shtesë, duke përfshirë 2 dëgjime, dhe është shpërndarë në të njëjtat platforma.	 https://obiliq.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/202507101530.pdf https://obiliq.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/202507221512.pdf https://obiliq.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/202508071024.pdf
Njoftimet për Konsultimet Publike	Nuk janë bërë njoftime të reja në ueb-faqen e komunës, por për secilin dëgjim buxhetor njoftimet janë postuar një ditë më parë në faqen e Facebook-ut të komunës. Njoftimet janë dizajnuar në formë fletushkash tërheqëse dhe janë shpërndarë aty pasi kjo platformë përdoret shumë më shpesh nga qytetarët.	 N/A
Procesverbalet e Konsultimeve	Procesverbalet e dëgjimeve buxhetore janë publikuar me detaje mbi numrin e pjesëmarrësve dhe komentet e tyre specifike. Këto dokumente u shërbejnë grupeve punuese për të analizuar secilën kërkesë individualisht, por gjithashtu u mundësojnë qytetarëve të shohin qartë se çfarë është diskutuar gjatë dëgjimeve.	 https://obiliq.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Procesverbalet-e-degjimeve-buxhetore-Buxhetimi-me-pjesemarrje-te-qytetareve-.pdf
Konsultimet e pranuar me shkrim	Asnjë kërkesë me shkrim nuk është pranuar gjatë konsultimeve për buxhetin 2026; të gjitha komentet dhe propozimet janë dhënë vetëm gjatë dëgjimeve publike.	N/A

PËRMBLEDHJE TABELARE E KONSULTIMEVE TË MBAJTURA

Emri dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data e mbajtjes	Nr. pjesëmarrëseve	i	Statusi i Kërkesa	
Degjim Publik per KAB me qytetaret (me pjesemarrje nga Antarët e Kuvendit Komunal, Këshillat e Lokal, OJQ, Grupi jo formal i grave, Grat në Biznes, Start-Up, nënat veteushqyese dhe qytetarët e Komunës së Obiliqit - Salla e Kuvendit Komunal	17.6.2025;	F 18	M 29	T 47	R P PJ A T
Degjim Publik per KAB me te gjithë qytetaret (me pjesemarrje nga Antarët e Kuvendit Komunal, Këshillat e Lokal, OJQ, Grupi jo formal i grave, Grat në Biznes, Start-Up, nënat veteushqyese dhe qytetarët e Komunës së Obiliqit	23.6.2025;	F 8	M 16	T 24	R P PJ A T
Obiliq – Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	23.7.2025	F 13	M 10	T 23	R P PJ A T
Mazgit I Ulet – Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	23.7.2025	F 0	M 6	T 6	R P PJ A T
Mazgit I Eperm – Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	23.7.2025	F 1	M 4	T 5	R P PJ A T
Plemetin - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	24.7.2025	F 0	M 5	T 5	R P PJ A T
Dardhishte - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	24.7.2025	F 1	M 12	T 13	R P PJ A T
Siboc - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	25.7.2025	F 1	M 4	T 5	R P PJ A T
Lajthishte - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	25.7.2025	F 0	M 5	T 5	R P PJ A T
Palaj - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	24.7.2025	F 0	M 7	T 7	R P PJ A T
Hade e Re - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	28.7.2025	F 2	M 8	T 10	R P PJ A T
Raskove - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	28.7.2025	F 0	M 10	T 10	R P PJ A T
Bashki - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	28.7.2025	F 0	M 17	T 17	R P PJ A T
Breznice - Degjimet Buxhetore me Pjesemarrje – Konsultimi I Pare	29.7.2025	F 2	M 4	T 6	R P PJ A T
Mazgit i Ulet – Votimi	30.7.2025	F 1	M 4	T 5	R P PJ A T
Dardhishte - Votimi	31.7.2025	F 2	M 24	T 26	R P PJ A T

Siboc- Votimi	1.8.2025	F 1	M 9	T 10	R P PJ A T
Lajthishte - Votimi	1.8.2025	F 0	M 7	T 7	R P PJ A T
Palaj - Votimi	1.8.2025	F 0	M 5	T 5	R P PJ A T
Hade e Re - Votimi	4.8.2025	F 1	M 10	T 11	R P PJ A T
Raskove - Votimi	4.8.2025	F 0	M 10	T 10	R P PJ A T
Bakshi – Votimi	4.8.2025	F 0	M 18	T 18	R P PJ A T
Breznice - Votimi	6.8.2025	F 5	M 10	T 15	R P PJ A T
Degjim Buxhetor per Buxhetin e Vitit 2016 – Me OJQ dhe Klube Sportive	21.8.2025	F 7	M 6	T 13	R P PJ A T
Degjim Buxhetor per Buxhetin e Vitit 2016 – Me Keshillt Lokal	21.8.2025	F 4	M 11	T 15	R P PJ A T
Gra—: 41 Burra-: 207 Totali—: 248					Refuzuar—: _____: Pranuar—12—: _____: Pjesërisht—: _____: Adresuar—36—: _____: Totali—48—: _____:

4. TABELARI I DETAJUAR SIPAS KATEGORIVE TË KËRKESAVE DHE STATUSIT

Për planifikimin e buxhetit 2026 dhe më tej, Komuna e Obiliqit ka organizuar tre lloje të dëgjimeve: dy dëgjime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028, 2 dëgjime publike të përgjithshme me qytetarë dhe pjesën tjetër të dëgjimeve– gjithsej 18 dëgjime buxhetore me pjesëmarrje në lokalitete të ndryshme të komunës. Këto forma konsultimi kanë siguruar përfshirje të gjerë të grupeve të interesit dhe transparencë në procesin e hartimit të buxhetit.

Më poshtë paraqiten dy tabela sipas llojit të dëgjimeve të mbajtura: tabela e parë përmbledh dëgjetimet për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe tre dëgjetimet publike të përgjithshme me qytetarë, ndërsa tabela e dytë përfshin të gjitha dëgjetimet buxhetore me pjesëmarrje në lokalitete të ndryshme të komunës.

Dëgjetimet Buxhetore me Qytetare për Buxhetin e Vitit 2026

Për procesin e planifikimit të buxhetit 2026 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028, janë mbajtur gjithsej katër dëgjime publike: dy me qytetarë në Sallën e Kuvendit Komunal më 17.06.2025 dhe 23.06.2025, me gjithsej 71 pjesëmarrës (26 gra dhe 45 burra), si dhe dy dëgjime të tjera më 21.08.2025 me organizatat joqeveritare, klubet sportive dhe këshillat lokalë, ku morën pjesë gjithsej 28 qytetarë (11 gra dhe 17 burra). Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat e detajuara për secilin nga këto takime.

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë: sugjerim/koment/vërejtje për buxhetin të vitit 2026	Statusi i kërkesës: Pranuor Refuzuar Pjesërisht Adresuar	Arsyetimi i Komisionit për pranimin e kërkesave të qytetarëve	Drejtoria përgjegjëse për realizimin e projektit
Investime Kapitale				
E pash që plani po bëhet për të gjithë komunitetin, dhe kjo më pëlqeu shumë. Kur po ndërtohen parqet nuk po është një pjesë e kufizuar për fëmijë me aftësi të kufizuara, psh në park në këndin e lojërave edhe për këto kategori, të mendohet.	OJQ “Dëgjo zërin tim”			
Interesoi për fondet e planifikuara për investime kapitale në Infrastrukturë ne f,sh Plemetin për vitin e ardhshëm, konkretisht për asfaltimin e rrugës "Sokoli" në Plemetin.	Faton Beka	Pjeserisht	Disa rrugë janë realizuar, por të tjera përreth hekurudhës dhe në fushën e sportit kanë mbetur. Po punohet me komunitetin Egjiptian dhe Ashkali. Gjithashtu, një projekt është duke u realizuarRenovimi I ndërtesave kolektive Baskefinanim komunale në vlerë 55,494.00 euro dhe .FKEE-s me vlere 55,494.81 euro Projekte të tjera janë në pritje për shkak të kontratës kolektive.	
Tema ishte ndarja e hapësirave për gratë dhe meshkujt në aktivitetet e komunitetit.	Magribe Salihaj	Aprovohet Pjeserisht	Eshte ne Plan te Komunes	
Mallera dhe Sherbime				

Sa mundeni te ngritin zërin për këta fëmije pra me aftësi të kufizuara ne qeveri, pra të loboni, ne kemi nevojë për një vend ku mundemi me kryer shërbime, e di qe ju keni bere krejt ata çka thate për qasjen në vende publike por kur shkojnë te këndi i lojërave, psh tek ulëset me bë një vend edhe për këta fëmijë me karroca në mesin e fëmijëve të tjerë	OJQ “Dëgjo zërin tim”			
Subvencione dhe Transfere				
Pyeti për mundësinë e mbështetjes për bletarët e Komunës së Obiliqit përmes Drejtorisë së Bujqësisë. Gjithashtu intereso për subvencionet për nënat vetushqyese apo gratë me fëmijë të sëmurë dhe ngriti çështjen e Shoqatës Kulturore "Tradita". që sipas saj nuk është subvencionuar këtë vit dhe dy vitet e fundit, përkundër rolit të saj kulturor	Xhemile Krasniqi	E Pranuar	Të gjitha mbështetjet për kategori të ndryshme, si OJQ-të dhe individë, janë pjesë e "Subvencione dhe transfere", në shumën 1,100,000.00 €, përfshirë subvencionet ne Bujqësi, bursat për studentë dhe mbështetjet për kategori e ndryshëme të shpërndara përmes drejtorive përkatëse.	
Kërkoi subvencionim për bujqit, si derivate dhe farë gruri.	Fuad Hashani	E Pranuar	Komuna në vazhdimësi i mbështet bujqit, përmes subvencioneve Do të shqyrtohet mundësia për të njëjtat edhe vitin tjetër, në përputhje me gjendjen buxhetore.	
Kërkoi më shumë mbështetje financiare, duke theksuar mungesën e funksionalitetit të zyrës së përdorur nga shoqata.	Azemine Simnica	E Pranuar	Mbështetjet financiare për kategoritë e ndryshme bëhen nga kategoria Subvencione dhe tranfere, nga drejtoritë përkatëse përmes thirrjeve publike	
Shtroi dy çështje që nuk kanë marrë zgjidhje që nga viti 2018 punësimi si bibliotekist dhe mbështetja financiare për shkrimtarë.	Fadil Curri	E Pranuar	Drejtoria e kulturës ne vitin 2025 per shoqatën e shkrimtarëve ka ndarë subvencion në vlerë 1,500.00 euro, kurse për punësim në bibliotek, drejtoria e Kultures vendos sipas nevojave	

Buxhetimi me Pjesëmarrje

Në kuadër të procesit të **Buxhetimit me Pjesëmarrje**, fillimisht u mbajtën takime konsultative me qytetarët për të mbledhur kërkesat dhe propozimet e tyre, ndërsa më pas u zhvilluan votimet në secilin lokalitet për të përcaktuar prioritetet përfundimtare. Në tabelën e mëposhtme paraqiten vetëm kërkesat e qytetarëve së bashku me statusin e tyre, sipas klasifikimit të bërë nga grupi punues.

Projektet e Votuara

Gjatë procesit të buxhetimit me pjesëmarrje, qytetarët në secilin lokalitet fillimisht paraqitën propozimet e tyre për projekte, të cilat më pas u hodhën në votim për të përcaktuar prioritetet që do të përfshiheshin në buxhetin e vitit 2026. Ndërsa tabela e përgjithshme përmbledh të gjitha kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve, në tabelën e mëposhtme paraqiten vetëm projektet që janë përzgjedhur dhe miratuar për t'u realizuar:

Lokaliteti	Projekti i Votuar
Obiliq	Rritja e subvencionimit për gratë në biznes dhe Start-Up, nga 100,000 € në 120,000 €
Mazgit i Ulët	Mirëmbajtja e ndriçimit publik
Mazgit i Epërm	Rregullimi i kanalizimit atmosferik dhe fekal dhe rregullimi i trotuarit në rrugën “Dita e Flamurit”
Plemetin	Ndërtimi dhe renovimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe të ujërave të zeza në rrugët “Vllaznim Bashkim”, “Sokoli”, “Vidovdanska”, “Bregaj”, si dhe nga hekurudha deri te lumi Sitnica
Dardhishtë	Ndërtimi i trotuarit në rrugën “Nuhi Kelmendi”
Siboc	Ndërtimi i kanalizimit në lagjen “Sadiku”
Lajthishtë	Rregullimi i segmentit të rrugës “Sabedin Pllana”
Palaj	Ndërrimi i gypit të ujësjellësit
Hade e Re	Rregullimi i ndriçimit publik dhe vendosja e kamerave
Raskovë	Rregullimi i stadiumit (rrethojat, muri dhe zhveshtoret)
Bakshi	Asfaltimi i rrugës “Luftëtari”
Breznicë	Asfaltimi i rrugës “Hysen Hajdari”

5. KONKLUZIONET DHE HAPAT E MËTEJSHËM

Procesi i dëgjimeve publike për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Obiliqit për vitin 2026 ka garantuar një nivel të lartë transparence dhe përfshirjeje të qytetarëve, këshillave lokalë, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Nga këto dëgjime u sigurua një pasqyrë e qartë mbi prioritetet dhe nevojat e komunitetit, të cilat janë reflektuar pjesërisht në projekt-buxhetin e hartuar nga ekzekutivi komunal. Konsultimet kanë treguar gatishmërinë e qytetarëve për t'u angazhuar në proceset vendimmarrëse, si dhe përkushtimin e komunës për t'i adresuar kërkesat në përputhje me kapacitetet buxhetore dhe ligjore. Hapat e mëtejshëm përfshijnë zhvillimin e raundit final të konsultimeve dhe shqyrtimeve që realizohen nga legjislativi komunal gjatë muajit shtator, ku projekt-buxheti i propozuar do t'i nënshtrohet debatit dhe miratimit nga Asambleja Komunale. Në këtë fazë, qytetarët dhe grupet e interesit kanë ende mundësi të japin komente dhe sugjerime përmes kanaleve zyrtare të konsultimit. Pas miratimit nga Asambleja Komunale, buxheti i vitit 2026 do të dërgohet për shqyrtim dhe miratim tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, duke përmbyllur kështu ciklin e plotë të planifikimit buxhetor. Komuna e Obiliqit mbetet e përkushtuar që të vazhdojë të forcojë procesin e buxhetimit me pjesëmarrje, të avancojë praktikën e transparencës, si dhe të sigurojë që prioritetet e ngritura nga qytetarët të adresohen në mënyrë sa më efektive dhe të drejtë në kuadër të zhvillimit të ardhshëm të komunës.

6. AFATET KOHORE

PËRGATITJA E RAPORTIT

Afati për përgatitjen e Raportit është më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarike, për projekt propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim.

PUBLIKIMI I RAPORTIT

Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas përfundimit të raportit nga grupi punues mbi shqyrtimin publik, raporti dërgohet tek zyrtari përgjegjës për konsultim publik i cili obligohet të siguroj publikimin ueb faqen zyrtare të komunës dhe në platformë për Konsultime publike të qeverisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

OBILIQ

Data: 23.07.2025

Ora e fillimit: 14:00

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, Drejtorë të drejtorive komunale, Kryetarë të këshillave lokal, Përfaqësues të organizatave joqeveritare, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetit për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Drilon Shala** (Organizata HELVETAS, Projekti “DEMOS”): Pyeti A ka një shumë të caktuar të alokuar për këtë vit në kuadër të kapitaleve për projektet e buxhetimit për pjesëmarrje, dhe si mund ta kuptojë qytetari se çfarë kërkesash mund të bëjë në këtë proces, pra a ka ndonjë shifër të specifikuar? Dhe e dyta Si ndikojnë obligimet që rrjedhin nga kontratat, sidomos nga kontrata kolektive, në buxhetin e komunës dhe në funksionimin e projeksioneve financiare, veçanërisht në aspektin e pagave të zyrtarëve?
- **Burim Gërguri**, Sqaroi se në këtë vit është hequr kufizimi i territorit, duke përfshirë të gjitha fshatrat përveç disa zonave të larguara si Hade dhe Shipitulle. Në aspektin e buxhetit, nuk janë vendosur kufij, procesi është i hapur për kërkesa dhe ide nga qytetarët. Megjithatë, ka një vlerësim të mundshëm të shifrave për projektet, siç janë parashikuar për ndihmën në ndërtimin e një parku, por nuk ka ende një kosto finale të përcaktuar për secilin projekt. Kjo është arsyeja pse është vënë një kufi të vlerës së projekteve që mund të variojnë nga 100 mijë deri në 3.5 milionë. Për më tepër, raporte gjashtëmujorë do të ndihmojnë në përcaktimin e progresit të realizimit të projekteve dhe të menaxhimit të planifikimit të buxhetit. Megjithatë, ka ende sfida dhe mbetje pas sa i përket realizimit të planit vjetor, duke kërkuar vëmendje më të madhe në menaxhimin e fondeve dhe monitorimin e realizimit të projekteve.
- **Besnik Salihu** (Zyrtar kryesor financiar ne DEFZH): është shumë problem të flasim me numra tani, mirëpo kur vjen qarkorja e dyte buxhetore atëherë do te shohim me qarte se ku jemi me obligimet aktuale kontrata trevjeçare, pastaj me nda shumen e sakte dhe se sa kemi mjete te lira, ndërsa sa i përket projeksioneve te pagave kjo ka te beje me koeficientin e pagave tek punëtori i cili caktohet ne baze te numrit te përgjithshëm te banoreve te Komunës psh Prishtina e ka për koeficientin profesional 1, 5.6 ndërsa Obiliqi 5.4, dhe ka shkuar me 19.000 dhe jo me 22.000 i cili është numri i përgjithshëm i banorëve ne komunën tone.
- **Shaip Paloji**: Fatkeqësi e madhe është se prezenca e qytetareve është e vogël edhe pse njoftimet janë gjithmonë ne kohe, prezenca e qytetareve do te ndihmonte shume ne zbatimin e duhur te buxhetit.

- **Drilon Shala:** Ose janë kryer te gjitha punët ose qytetaret po ngurojnë, duhet te jemi me fat se është organizuar ky lloj debati, sepse ku me mire se me i shfaq mangësitë dhe me i pas mundësitë reale që ti jetësoj një ide prej vet qytetareve.
- **Besnik Salihu:** ndoshta arsyeja kryesore është sepse ka për çdo dite kërkesa nga me te ndryshmet, e te cilat po behën përmes zyrës pritëse ne objektin e Komunës se Obiliqit, dhe te cilat po mundohemi t’iu përgjigjemi ne kohe.
- A keni plan për te mbjell fidanë, edhe ne kuptim te sigurisë edhe ne kuptim te hijeve, sidomos ku ka kënde te lojërave për fëmijët
- **Besnik Salihu:** Se besoj qe jemi keq sa i përket mbjelljes se fidanëve, sidomos ne shesh kemi mjaftueshëm për mbjelljen e fidanëve, por edhe ne parqet kudo qe janë, gjithashtu edhe ne dalje te Obiliqit. Nëse ka ndonjë kërkesë per ndonjë dru qe është thare atëherë ne reagojmë menjëherë dhe e ndërrojmë.
- **Drilon Shala:** Ku e kane qëllimin Komuna e Obiliqit t’i orientoj subvencionet, nëse jo për projekte kapitale, te paktën me i dit nevojat e qytetareve, a ka ndonjë fokus te veçantë nga qytetaret, se çfarë duhet te jete me prioritet qe te subvencionohet.
- **Besnik Salihu:** kemi disa OJQ goxha aktive, qytetaret përmes tyre bëjnë kërkesa, edhe përmes subvencioneve qe kemi pasur nga Drejtoria e Financave për Gratë ne Biznes, për startup biznese te grave, për biznese te grave ne bujqësi.
- **Burim Gerguri:** Obiliqi ka planin zhvillimor komunal dhe hartën zonale te aprovuar dhe është një kërkesë e jashtëzakonshme dhe shume qytetar janë shume te interesuar se çfarë do të ndodhë me pronat e tyre, dhe të njëjtën kohë jemi te ndërtimi kadastral në zonat Breznicë, Kozaricë dhe Obiliq që po ndodhë pas 80 viteve që po zgjidhet problemi i pronave
- **Drilon Shala:** Dua të propozoj një qendër rinore te funksionalizuar me infrastrukturën qe i nevojitet për kryerjen e aktiviteteve rinore dhe e dyta ka te beje me sigurimin e infrastrukturën për personat me aftësi te kufizuara, sidomos ne institucione publike apo lokacione ne qytet sidomos me pjerrinat, apo sinjalistikën për të verbrit ku konsiderohet që nuk ekzistojnë, përveç sinjalistikën rrugore për përdoruesit e shkopit, që kemi të bëjmë me semafor te akustika.
- **Burim Gerguri:** Drejtoria për Zhvillim, Drejtoria për infrastrukturë dhe e Administratës kanë bërë një plan dhe këto vitet e fundit çdo investim duhet paraparë ne bazë të Udhëzimit Administrativ edhe lejet e reja te cilat jepen se paku pjerrinat dhe shkopi edhe investimet kapitale te cilat janë duke u kryer sot po flas me trotuare dhe ndriçime janë të përfshinë, tek pjesa e qendrës rinore po presim nga Ministria e Kulturës që të ndërmarrim një hap të tillë, së bashku me zyrtarë të QR, po diskutojmë për një lokacion të mundshëm, me udhëzim Ministria e Kulturës i themelon ne i mirëmbajmë dhe jemi në bisedime.
- **Burim Gerguri:** Pasi që nuk ka propozime konkrete atëherë unë do ta jap një, prej 100.000 ne 120.000, do të jetë subvencioni për gra, apo ndryshe buxheti gjinor.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se dëgjimet buxhetore janë një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 14:52 me gjithsej 23 pjesëmarrës prej tyre gra 13, burra 9

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

MAZGIT I ULËT

Data: 23.07.2025

Ora e fillimit: 16:00

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, Drejtorë të drejtorive komunale, Kryetarë të këshillave lokal, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetit për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Ejup Curri:** Asfaltin që e keni shtuar tek ne është 2cm, por letra që na keni dhënë tek ne është 8cm, ajo ka fillu edhe me u asfaltu dhe me asfaltu.
- **Burim Gërguri:** ne do ta dërgojmë edhe njëherë edhe dikë për inspektim të gjendjes dhe mund marrim masa ashtu edhe sic duhet. E lëm një takim me kryetarin dhe për këto probleme duhet diskutuar më gjerë dhe më gjatë.
- **Besart Berisha:** Popozimi im është Asfaltimi i rrugës “Kozmaqi”, është një gjatësi rreth 300m, rrugë kjo që i lidh dy Mazgitat.
- **Burim Gërguri:** Mos ka kontest pronësie?
- **Besart Berisha:** Jo nuk ka, është rrugë me kadastër, Mazgiti ka një histori pak më ndryshe e ka Komostacionin, sepse në të kaluarën kemi pasur raste kur qytetarët na kan kërkuar të asfaltojmë rrugët, por me kadastër ka qenë pronë e qytetarëve.
- **Imer Tërholli:** unë kam një propozim i cili është mirëmbajtja e ndriçimit public, dhe problemi I varrezave.
- **Xhavit Aliu:** Asfaltimi i segmentit të rrugës “Agron Rrahmani”, diku rreth 20m, por edhe për varrezat sepse nuk ka vend më në varreza.
- **Përparim Haziraj:** Për pjesën tek rruga “Agron Rrahmani” për parkun ku ka qenë në plan të ndërtohet por është lënë anash, kam qenë edhe tek nënkryetari ai më është përgjigjur se për momentin nuk ka mundësi për arsye sepse kontrata kolektive ka bërë të pamundurën, dhe pyetja ime drejtuar ju është se kur parashihet të filloj ndërtimi I parkut?
- **Burim Gërguri:** Ky park është I buxhetuar, dhe nuk ka mundësi të marr hapsirën publike dhe ta bëjë private, për fat të mirë Mazgiti ka shumë tokë.
- **Zarife Beluli:** Nuk është faji jonë ky sepse Kontrata kolektive na ka marr paratë tona pa na pytur ne na marrin buxhetin aty ku gjejnë, I kanë marrë parat e ngrohja qendrore.
- **Përparim Haziraj:** A ka mundsi që ngrohja qendrore të filloj edhe në Mazgit apo nuk është në plan.
- **Burim Gërguri:** Kur është bërë faza e parë e studimit të fizibilitetit dhe është Mazgit, Milloshevë, Raskovë, Bashki dhe Dardhishtë, dhe është bërë për kokë banori, mbi Sitnicë as që kemi filluar sepse banorët janë në zhvendsoje, Obiliqi parashihet të pajiset në tërsi, dy Mazgitat, Millosheva pastaj Dardhishta, këtu luan rol numri I banreve, tendenca ne rritje, numri I fëmijëve, dhe kthimi në investim.
- **Përparim Haziraj:** a ka ndonjë datë kur do të përfundoj?
- **Burim Gërguri:** 13 milion është kryer në Obiliq, po presim prej termocentralit deri tek zona e Hashanve, mu leshu pastaj të vazhdoj për Obiliq, të gjitha gjasat kanë qenë të përfundohet në vitin 2024 por për shkak të pandemisë, për shkak të Kontratës Kolektive është shtyer deri në vitin 2025, po presim edhe pse ende nuk është kryer sidomos funksionalizimi I kuvendit, bllokimi I fondeve në BE.

- **Përparim Haziraj:** Po për pjesën e mbështetjes elektrike a do të ketë diqka për këtë? Sepse ne jemi pjese e dëmtuar.
- **Burim Gërguri:** Jo, qe tre herë Qeveria nuk e aprovon vendimin. Sa I përket varrezave, ne jemi te pajtimt të gjejmë një zgjidhje dhe të ofrojmë një gjithashtu, por ne edhe me Kryetarin e kemi diskutuar se bashku me ju, dhe ju kemi thënë gjene një hapsirë publike, ose hapsirë të cilën ne mund ta shpronësojmë, sepse ne kemi gjet vendin, por askush nuk ka pranuar që të ketë varrezat afër shtëpisë së tij.
- **Xhavit Aliu:** Rregullimi i trotuarit në rrugën “Agron Rrahmani”.

Me datën 30.07.2025 do të mbahet takimi në orën 16:00, ku do të votoni se cilin propozim ju doni ta kaloni, dhe për vitin e ardhshëm planifikohet në buxhet.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 17:15 me gjithsej 6 pjesëmarrës prej tyre gra 0, burra 6.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

MAZGIT I EPËRM

Data: 23.07.2025

Ora e fillimit: 17:35

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, Drejtorë të drejtorive komunale, Kryetarë të këshillave lokal, Përfaqësues të organizatave joqeveritare, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetit për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Feim Raçi:** Rruga “Dita e Flamurit”- të bëhet Kanalizimi 500-600m për afërsisht.
- **Besnik Salihu:** Ne rregull a ka ndonjë projekt tjetër?
- **Qytetarët njëzëri:** Le të përfundohet njëherë ky propozim.
- **Burim Gërguri:** Mirë ndonjë projekt tjetër?
- **Driton Selmani:** Unë kam ardhë për shkollën fillore “Ibrahim Rugova” Mazgit i Epërm, tek nxemjet kjo shkolle nuk ka nxemje.
- **Burim Gërguri:** Nuk do ta marr si propozim fare, sepse për mirëmbajtjen e shkollave, këtë vit do të rregullohen shumica e kaldajave prej dru, e thëngjill do të zëvendësohet me pelet sepse është projekt, e kemi filluar edhe një projekt kjo është me klimë e di që është goxha problem për fëmijët me pas klimë, jo vetëm kjo por edhe gjendjen sanitare me u rregullu sepse shumica e punëtorëve teknik të cilët kanë punuar kanë qenë edhe me shëndet jo të mirë dhe na është dashtë që të marrim puntor nga NPL që të mbushim zbrazëtirën. Po behet një reduktim i nxënësve ne shumë shkolla të Obiliqit. Ky problem do te zgjidhet në këtë vit dhe nuk mund të hyj për vitin 2026 sepse është problem që nuk mund të pres më gjatë.
- **Urim Grajqevci:** Dy projekte për digjitalizimin në shkolla kemi pasur por nuk kemi mundur ti realizojmë shkaku i afateve nga OSH-ja, e kontrata kolektive ka ndiku shume jo vetëm në sektorin e Arsimit por edhe në shumë sektorë të rëndësishme.
- **Burim Gërguri:** Sa i përket shumë problemeve në komunitet është ardh edhe nga faktori njeri sepse shumicës nga ne na duhet vetdijësimi dhe duhet që kamerat të çertifkohen

Pasi që ishte vetëm një projekt i cili është kanalizimi, atëherë me propozim të Shefit të Kabinetit kaloi direkt.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 18:12 me gjithsej 5 pjesëmarrës prej tyre gra 1, burra 4

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

PLEMETIN

Data: 24.07.2025

Ora e fillimit: 16:11

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, kryetari i këshillit të fshatit, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetit për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Vahudin Ibrahim** (*Kryetar i këshillit të fshatit*): Ne kërkojmë nga Komuna që të bëjnë ndërtimin dhe renovimin e rrjetit të kanalizimit fekal dhe të ujërave të zeza në rrugët “Vllaznim Bashkim”, “Sokoli”, “Vidovdanska”, “Bregaj”, si dhe nga hekurudha deri te lumi Sitnica.
- **Burim Gërguri**: Ne rregull faleminderit per propozimin tuaj, ndonjë propozim tjetër?
- **Vahudin Ibrahim**: Po edhe sa i përket ujësjellësit, gjatë verës nuk kemi shtypje të ujit.
- **Burim Gërguri**: Është problem i gjithanëshëm, nuk është diçka që ndodhë vetëm në Plemetin.
- **Bekim Berisha**: unë kam një propozim konkret na duhet trafo elektrike.
- **Burim Gërguri**: Ajo është me KEDS-in, nuk është me Komunën, sepse kur ndërtohet një pronë kërkohet një leje nga KEDS-i, dhe nëse ju nuk keni leje, nuk dihet saktë numri i shpijave.
- **Avdyll Mustafa**: Edhe nje park nëse ka mundësi.
- **Burim Gërguri**: Te banesat e kemi ndërtuar tek banesat por ju nuk po e mirëmbani, mirëpo në pjesën ku po thoni ju a e dini a ka ndonjë pronë publike ku mundemi të bëjmë ndërtimin e parkut.
- **Burim Gërguri**: Po mbetet vetëm një propozim nga ana juaj i cili është “ndërtimin dhe renovimin e rrjetit të kanalizimit fekal dhe të ujërave të zeza në rrugët “Vllaznim Bashkim”, “Sokoli”, “Vidovdanska”, “Bregaj”, si dhe nga hekurudha deri te lumi Sitnica”, dhe për këtë arsye ky projekt kalon menjëherë, ndërsa sa i përket trafave se bashku me Vahudin do ta bëjmë një kërkesë.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 16:56 me gjithsej 5 pjesëmarrës prej tyre gra 0, burra 5

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

Dardhishtë

Data: 24.07.2025

Ora e fillimit: 18:40

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, kryetari i këshillit të fshatit, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetit për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Avdurrahman Mexhuani** (Kryetari i këshillit të fshatit): Kërkoi të bëhet ndërtimi i kolektorit (mbulimi i kanalit) në gjatësi prej 700 m e cila vjen nga Prishtina.
- **Ismet Gashi**: Kërkoi të bëhet ndërtimi i segmentit të trotuarit në rrugën “Ali Maloku” (prej lagjes Tërnavë deri tek lagja Gashi) sepse ka shumë pasiguri sidomos për fëmijët.
- **Agim Halimaj**: Kërkoi që të propozohet ndërtimi i trotuarit në rrugën “Nuhi Kelmendi”.
- **Arsim Halimaj**: Kërkoi që të propozohet të krijohen hapësira gjelbëruese, të bëhet mbjellja e drunjëve në rrugën “Nuhi Kelmendi”.
- **Burim Gërguri**: Sqaroj se si qytetar i Kryshecit dëshiron vet të ndërtohet fushë sportive dhe park në lagjet: Halimaj, Fanaku, Sahiti.
- **Agron Zeqiri**: Kërkoi që të bëhet ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lagjen Zeqiri.
- **Driton Dobratiqi**: Kërkoi që të bëhet asfaltimi i rrugës “Hazir Merlaku”.
- **Ylber Kosumi**: Kërkoi të bëhet asfaltimi i rrugës “Zhitia” segmentin e katërt tek lagja e Kosumëve.
- **Driton Raçi**: Asfaltimi i rrugës “Qazim Gashi”, në lagjet Raçi, Bytyqi dhe Selimi
- Gjatë mbledhjes qytetarët shfaqën pakënaqësitë e shumta në lidhje me trotualet, me rrugët e ndriçimin që e ka shkaktuar ndërtimi i hekurudhave
- Burim Gërguri shtoi se me datën 31.07.2025 te enjten në orën 18:30 të votohet propozimet, dhe me shumicë të votave të kaloj dhe të procedohet me tutje, nga nëntë propozime një i kalon kuvendit direkt.
- Burim Gërguri: Së bashku me kryetarin e kem marr ta bejmë ndërtimin e fushës sportive dhe parkun në atë lagje, por së pari duhet të vazhdojmë me procesin e shpronësimit sepse tokë nuk ka ajo lagje dhe Agimi e din këtë dhe përmes familjes Hashani është paraparë që të vijmë deri në një ujdi ta aprovojmë përmes Kuvendit Komunal që duhet shpronësuar ajo tokë, në mënyrë që të bëhet për komunitet, fillimisht ndoshta do të ndërtohet edhe një objekt për të pame apo komunitet, dhe të bëhet një fushë sportive dhe një park i vogël, por duhet të kaloj me kuvend. Ndërtimi i trotuarit besoj që do të jetë si fushë më e lehtë sepse do të ketë mirëmbajtje, këtë vit duhet të mbjellim drunjtë por që për shkak të buxhetimit dhe masave të thesarit ka ndikuar që në shumicën e projekteve të zvarriten pa dashje. Jemi në një fazë të rindërtimit kadastral po zgjidhet një problem i kamotshëm i trashëgimisë e pronës.

Me datën 31.07.2025 do të mbahet takimi në orën 18:30, ku do të votoni se cilin propozim ju doni ta kaloni, dhe për vitin e ardhshëm planifikohet në buxhet.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 19:56 me gjithsej 13 pjesëmarrës prej tyre gra 1, burra 12.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

SIBOC

Data: 25.07.2025

Ora e fillimit: 17:35

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, kryetari i këshillit të fshatit, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetimit për pjesëmarrje për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- Afrim (Kryetari i këshillit të fshatit): Bëri të ditur që Siboci, ka nevojë që të ndërtohet që nga fillimi sepse është shumë keq, në një nga lagjet e Sibocit kanalizimi qe dy vite është në gjendje shumë të rënduar. E tjetra është edhe ndriçimi i cili prej dy vitesh nuk ka.
- Burim Gërguri: Sqaroj se sa i përket kanalizimit, është problem mirëmbajtje dhe se DSHPE do të bëjë një zgjidhje, por me ndërtimin e rrugës do të finalizohet gjithëqka, e edhe pastrimi i prrockës e cila here pas here ka edhe ujëra te rrëmbyeshëm kur ka reshje. Komuna e ka marrë përsipër kanalizimin por për detyrë ka Ujësjellësi, të cilit si qytetar paguajmë 2.75 cent në muaj, e dimë që gjithashtu edhe po kemi probleme me mungesë të ujit. Javën e kaluar Drejtori i DSHPE është takuar me drejtorin teknik të prodhimit në fabrikë për mungesën e ujit në veçanti në Siboc, Lajthishtë, Palaj dhe Hade. Por bashkërisht ne do ti zgjidhim këto probleme.
- Afrim: Ne kemi bërë edhe kërkesën që objektin që të bëhet shtëpi për të pame, është e gatshme vetëm pak investim duhet.
- Burim Gërguri: Këto objekte janë paraparë që të bëhen për shërbime të ofiqarisë, une kam kërkuar që të bëhen qendra për shërbime për komunitet, çfarë do të thotë kjo që të shfrytëzohen qoftë për te pame qoftë për takime të tilla, për fushata politike. Tash te vazhdojmë me propozime konkrete.
- Afrim: Funkcionalizimi i shtëpisë për komunitet
- Driton Raci: Ndërtimi i kanalizimit rruga Hamidi- Siboc konkretisht lagjja Sadiku
- Rrethoja e shkollës, apo fushës
- Urim Grajqevci : Është në plan të mirëmbajtjes këtë vit duhet të përfundohet dhe e kemi në plan,
- Burim Gërguri: Sa i përket ndriçimit e kemi në plan të mirëmbajtjes jemi në fazën finale të lidhjes së kontratës, por sa i përket pse nuk janë duke përfunduar ka të bëjë me atë se kontrata kolektive na janë marrë mjetet monetare. Këto janë dy nga kërkesat e qytetarëve dhe që është e shpeshtë Kanalizimi edhe pse nuk është kompetence e jona dhe ndriçimi.
- Afrimi: Duhet edhe të vendoset edhe mburoja tek Ibri
- Burim Gërguri: E kemi vendosur por është dëmtuar nga kalimi i kamionëve me pesha të mëdha por Drejtori i DSHPE-së do ta rregulloj sepse ka nevojë nga të gjitha anët.
- Kush ka të bëjë me mirëmbajtjen e pllakës se dëshmoreve, “Pushka e pare e lirisë”
- Burim Gërguri: Ne i kemi vendosur edhe dritat në lapidar por nga qytetarët janë marrë, na është ardh edhe një propozim prej Shoqatës të dalurve nga lufta, e kemi diskutuar ndërtimin e një kulle, që të jetë një muze brenda, duhet të gjejmë dëshmi, fotografi, një zyre të mbajmë takime, por kur kemi biseduar me Ministrinë na është thënë që nuk kemi drejtë ta bëjmë.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i

rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale. Dhe i ftoi të votojnë me datë 01.08.2025 në orën 17:30.

Takimi përfundoi në ora 18:05 me gjithsej 5 pjesëmarrës prej tyre gra 1, burra 4.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

LAJTHISHTË

Data: 25.07.2025

Ora e fillimit: 18:30

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetit për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Behlul Prenku:** Ndërtimi i segmentit rruga “Sabedin Pllana” te xhamia, sepse është rrugë nga kalojnë nxënësit. Është tokë publike nuk do të ketë probleme për ndërtim.
- **Burim Gërguri:** Në rregull, kur vijnë inxhinierët ju pyesin cila rrugë, që të bëjnë saktë incizimin.
- **Pajazit Dedinca:** ndërtimi i rrugës “Ulpiana”
- **Valon Pllana:** Ndërtimi i parkut në Lajthishtë, është pronë publike, ndalen edhe mbeturinat.
- **Burim Gërguri:** Ndonjë propozim tjetër
- **Besfort Kurshumliu:** Ndërtimi i rrugës “Mehmet Dedinca” 80 metershe Lagjja Kurshumliu (te shkolla)
- **Valon Pllana:** Nuk është një propozim por Lajthishta ka nevojë edhe për trotuare sepse na nevojiten sidomos për fëmijë.
- **Burim Gërguri:** E di që ka nevojë por nuk ka pronë publike lëshoni ju tokën e ne menjëherë e bëjmë edhe trotuarin. Ne kemi ardhë por nuk ka leju askush që të merret rruga nga ju. Nuk kemi lënë fshat pa trotuar, që ta lëmë Lajthishtën e kemi menduar që nga varrezat deri tek shkolla, dhe prej shkollës deri aty ku lidheni me Palaj. Për shkak të pozitës gjeografike që ka Lajthishta e bënë shumë të vështirë ndërtimin sepse po bëhet edhe rrëshqitja e dheut, është diçka natyrore.

Me datën 01.08.2025 do të mbahet takimi në orën 18:30, ku do të votoni se cilin propozim ju doni ta kaloni, dhe për vitin e ardhshëm planifikohet në buxhet.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 19:16 me gjithsej 6 pjesëmarrës prej tyre gra 0, burra 6

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

Palaj

Data: 24.07.2025

Ora e fillimit: 19:30

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, kryetari i këshillit të fshatit, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetit për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Bajram Paloji:** Kërkon që të largohen nga këtu, sepse po ju pamundësohet që të marrin edhe leje ndërtimore.
- **Burim Gërguri:** E di është shumë jo e drejtë sepse në fillim banorët e Palaj por edhe vendbanimeve tjera ndoshta nuk kanë dashur fare të ndërtojnë shtëpiat e tyre, por sot ata nuk lejohen as edhe ti rinovojnë ato, pa i pranuar kushtet që nuk do të rimbursohen kur të ndodhë zhvendosja, kjo ka ndodhë gjatë kohës kur unë kam qenë kryesues i kuvendit të Obiliqit. Ne në pamundësi që ti shfrytëzojmë tokat tona stërgjyshore është kriju edhe Ligji për Obiliqin, i cili nuk po na lejohet të zbatohet tërësisht, por vetëm sa i përket buxhetimit, kur e kemi aprovu këtë ligj është mundësu që për të hyrë në punë në institucione publike këtu në Obiliq të kenë përparësi banorët e Obiliqit. Në rregull a ka ndonjë propozim konkret.
- **Hysen Paloji:** Të bëhet ndërtimi i Gypit kryesor të ujit, pastaj ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimit.
- **Faton Beka:** Kushtet që jetojmë ne e dimë që jemi në zonë me interes të vecantë, kisha rekomanduar që në shkollë të bëhet ndërtimi i parkingut dhe ristrukturimi i oborrit të shkollës.
- **Izet Paloji:** Kemi problem me rrethojat në varrezat sepse po vjedhen nga qytetarët e thjeshtë, pra të bëhet rregullimi i varrezave, dhe gjithashtu të bëhet rregullimi i rrugës.
- **Burim Gërguri:** Nuk e di nëse ju kujtohet në vitin 2014, e kemi marrë një vendim ku janë pllakat e dëshmorëve dhe i kemi vendosur dritat solare, të gjitha këto janë marrë nga qytetarët
- **Milaim Paloji:** Objekti i shëndetësisë të shndërrohet në shtëpi për komunitetin.
- **Burim Gërguri:** Problemi i ndriçimit është problem real e di, por po shpresojmë që këtë vit të përfundojmë me kontratën kolektive, dhe për këtë arsye mirëmbajtja po bëhet pak nga pak. Kemi fol edhe në Lajthishtë për trotuare që të lidhet me Palaj por nuk kemi tokë publike.

Me datën 01.08.2025 do të mbahet takimi në orën 19:30, ku do të votoni se cilin propozim ju doni ta kaloni, dhe për vitin e ardhshëm planifikohet në buxhet.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 20:18 me gjithsej 7 pjesëmarrës prej tyre gra 0, burra 7.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DEFZH
Diskutim Publik

“Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028”

PROCESVERBAL

HADE E RE

Data: 28.07.2025

Ora e fillimit: 16:35

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, kryetari i këshillit të fshatit, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Burim Gërguri sqaroi se Hadja nuk është pjesë e këtij organizimi, për arsye sepse janë në proces të zhvendosjes së bashku me Shipitullën, dhe se sot jemi në një lagje të re të quajtur Hadja e re. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetimit për pjesëmarrje për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Ruzhdi Mirena:** Hadja gjithmonë ka qenë e anashkaluar, kemi bërë edhe më parë disa kërkesa, por kemi hasur në vesh të shurdhër por po shpresojmë tash e tutje ju kemi afër.
- **Burim Gërguri:** Jemi qeverisja e pare qe kemi shtruar rrugë, sepse kryetari ka qenë i prerë, sepse ka thënë në çoftë se vetëm një javë të qëndrojnë në atë vend ne duhet ti dërgojmë ujin e kanalizimin. Problemet janë te vjetra dhe problemet nuk po zgjidhen, zhvendosja e fundit është mizërie, Qeveritë e harronin konsensusi qe ju po largoheni prej tokave stërgjyshore, ne si Komunë e Obiliqit e kemi dërguar në Hade të vjetër kanalizimin në rrugën deri tek Mirenet, ju keni dal por ka ende ne Hade, të cilët po përballën me probleme më të mëdha, është mbyll edhe shkolla shkak qe nuk ka nxënës, sepse janë shumë pak që një shkollë nuk mund të funksionoj.
- **Ruzhdi Mirena:** Rregullimi i ndriçimit dhe vendosja e kamerave.
- **Rrustem Mirena:** Rregullimi i kapakëve të njehsorëve elektrik.
- **Shaban Mirena:** Rregullimi i oborrit të shkollës.
- **Burim Gërguri:** Ne e kemi pasur edhe në plan që të bëjmë edhe rrethimin e oborrit të shkollës por edhe ndërtimin e një parku.
- **Shaban Mirena:** Renovimi i kanalizimit.
- **Vehbi Shala:** Rregullimi i rrethojave të varrezave dhe rregullimi i rrugës.
- **Alban Shala:** Vendosja e policëve të shtrirë në rrugë.
- **Burim Gërguri:** Rruga kryesore është me Ministrinë, i bjen në Magjistrale. Pozita gjeografike e Hades së Re është shumë e vështirë, sepse verës është shumë lehtë por dimrit, bëhet shumë më vështirë.
- **Rrustem Mirena:** Park dhe kënd i lojërave
- **Burim Gërguri:** Kjo është lagje e re, dhe ka nevojë por edhe do të investohet me çfarëdo që ka nevojë me fusha sportive, shkolla, xhamia edhe kishë, biblioteke, për park e për të gjitha çfarë ka nevojë një komunitet, sepse është menduar si një lagje urbane.
- **Ruzhdi Mirena:** Na duhet edhe një transport urban.
- **Burim Gërguri:** Ne kemi menduar që të bëjmë një blerje të linjave të transportit, po mendojmë edhe me DSHPE që të paktën të ketë një linjë që ti bie në rrugën kryesore.

- Po flitet se do të ketë mësim të kombinuar, dhe ne shumë mirë e dimë që efektin që e ka mësimi i kombinuar në shkolla është shumë i vogël andaj ne kemi menduar edhe të largojmë fëmijët.
- **Burim Gërguri:** Nëse ju i dërgoni fëmijët në këtë shkollë atëherë nuk do të ketë mësim të kombinuar por nëse ju vazhdoni ti dërgoni në shkolla tjera si në Shkabaj e në Prishtinë ne nuk kemi zgjedhje tjetër
- **Urim Grajqevci (Zyrtar në DA):** Nëse ne klasa te para fëmijët vijnë këtu, behet norma dhe nuk bëhet mësim i kombinuar, edhe pse po shkojnë ne shkolla ne Prishtinë ne ju sigurojmë transport miqësisht. Në drejtimet që i kemi këtu në Obiliq lejoni fëmijët që të vijojnë mësimin këtu, por në drejtimet si Mjekësi në Obiliq nuk ka ne nuk ju obligojmë as këshillojmë që të ndërrojnë drejtim.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale. Dhe i ftoi të votojnë me datë 04.08.2025 në orën 16:30 në të njëjtin lokacion në mënyrë që të gëzojnë njërin nga këto propozime.

Takimi përfundoi në ora 17:18 me gjithsej 10 pjesëmarrës prej tyre gra 2, burra 8

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DEFZH
Diskutim Publik

“Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028”

PROCESVERBAL

RASKOVË

Data: 28.07.2025

Ora e fillimit: 18:35

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, kryetari i këshillit të fshatit, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetimit për pjesëmarrje për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Sabit Gashi:** Ndërtimi i parkut në Raskovë.
- **Sabit Gashi:** nga shkolla deri tek stacioni me bo një muri mbrojtës sepse shume here ka ndodhur qe fëmijët duke luajtur ka hyre vetura me shpejtësi te madhe, gjithashtu edhe për qenet endacak.
- **Burim Gërguri:** E kuptoj por rruga është magjistrale dhe është kompetencë e Ministrisë, nuk lejon as një veprim në rrugë, me qeveritë e kaluara jemi marrë vesh disi, i kemi bërë 100 kërkesa nuk kanë dhënë as edhe një cent për investime kapitale, as për ngrohjen qendrore. Ju e dini që mandatin e kaluar Naimi, drejtori i shërbimeve publike është mundu ti kryej të gjitha
- **Agim Miftari:** Dislokimi i urës së metaltë nga Raskova deri tek kufiri i Bakshisë.
- **Selim Gervalla:** Rregullimi i stadiumit (rrethoja, muri dhe zhveshtoret), Stadiumi po shfrytëzohet si parking, tani për tani fëmijët po luajnë.
- **Bastri Shabani:** Ndërtimi i trotuarit në rrugën Raskovë-Milloshëvë,
- **I panjohur:** Lumi Llap çfarë ka plan Komuna.
- **Burim Gërguri:** Brena e kufijve administrativ disa thonë po disa jo, çdo veprim që bënë brenda lumit Llap ti mundesh me marrë leje në Komunë por nëse nuk merr leje në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor atëherë nuk ke bërë asgjë, sepse një rast në Milloshevë, ka dashtë të bëjë një investim milionësh, një bazend por ka pasur probleme me ata të Departamentit. Ne e kemi rregulluar njëherë Llapin para 4 vitesh kemi pas një marrëveshje me Komunën e Vushtrrisë dhe kemi zgjidh problemin e Sitnicës e pak a shume e kemi trajtuar, duhet mi ruajt lumenjtë nuk duhet mu derdh ujërat e zeza ne llap, te ndërtojnë kolektor është përgjegjësi e KUR Prishtina.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale. Dhe i ftoi të votojnë me datë 04.08.2025 në ora 18:30.

Takimi përfundoi në ora 19:09 me gjithsej 10 pjesëmarrës prej tyre gra 0, burra 10.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Diskutim Publik

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

BAKSHI

Data: 28.07.2025

Ora e fillimit: 19:35

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, kryetari i këshillit të fshatit, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetimit për pjesëmarrje për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Burim Gërguri:** Lumin që derdhët në Llap, e ai në Sitnicë, arsyeja që nuk po behet trajtimi i ujërave të zeza ka qenë i Ministrisë, ata po heshtin ne mund ti trajtojmë ujërat e zeza por nëse vazhdohet dëmtimi nga Prishtina e nga Podujeva atëherë pse po trajtohen sepse është pa rezultat, sepse kur trajtohet duhet trajtuar nga pika më e ulët deri në pikën më të lartë në mënyrë që më të mos bëhet e njëjta. Pozita gjeografike e Obiliqit është ashtu që të gjitha ujërat e zeza të derdhën në Obiliq, Fushë Kosova i derdh në lumin Sitnica, në Dardhishtë derdhën nga Prishtina, në pjesën e fshatit tuaj derdhën këto fshatrat tjerë si Trudë e prej Vranjevcit e pastaj shkarkimi i ujrave atmosferike që e bën autostrada. Pra pa u bë një trajtim i përgjithshëm nuk mund të vazhdohet ndryshe. Andaj kërkoj nga ana juaj të bëhen propozimet e juaja e sot një javë të votoni atë që ju kenë më së shumti nevojë, e gjithashtu të gjitha projektet të janë pa probleme pronësore.
- **Zymer Zymeri:** : Do te doja te pyesja zyrtarin e Arsimit pse është shtyre afati për regjistrim në çerdhe.
- **Urim Grajqevci:** ka pasur kërkesa nga prindërit sepse ka qenë kohë e pushimeve dhe e kemi parë të arsyeshme të vazhdohet edhe për pak kohë.
- **Zymer Zymeri:** unë do të kisha rekomanduar që kjo “rekë” të qelet dhe të bëhet me gurë e edhe si shëtitore. Të bëhet rregullimi i rrugës me trotuare të mos pyetet askush nëse unë kam qenë ai që kam marrë tokë pronësore atëherë merreni atë tokë që ju takon qytetarëve pra të vazhdojmë me kadastrë. E gjithashtu kjo rruga këtu të lidhet me Llazarevë.
- **Dorent Rushiti** asfaltimi i rrugës Bakshi- Lazareve.
- **Burim Gërguri:** Ky projekt është një njeri një propozim, nuk mund të vazhdojmë me shumë propozime nga një person. Le ta merr si propozim ndonjëri nga tjerët që janë prezent. Rekën kemi ardhë para disa viteve ta pastrojmë e ta thellojmë por filluan problemet në mes jush, dhe komuna nuk është për të krijuar mosmarrëveshje në mes familjeve, por ti zgjidh problemet. Në Obiliq është rindërtimi kadastral ku përfshihet Obiliqi si zonë kadastrale, Brezhnica, Kozaricë dhe Dardhishtë, po besoj që vitin e ardhshëm e kemi në Raskovë Bakshi dhe Milloshevë, zgjedhja e trashëgimisë do të jetë fal, rindërtimi është të legalizojmë atë tokë që është ndërtuar me “tahmin”, i din vijat por nuk është qind për qind.
- **Kasim Musliu:** Asfaltimi ne rrugën “Luftetari”.
- **Burim Gërguri:** E kemi shtruar zhavorr, kemi intervenuar në kanalizim dhe në ujësjellës, zhgjidhni problemet pronësore, ju propozoni për këtë jemi këtu.

- **Faton Mihani:** Asfaltimi i rrugës “Mihani”
- **Bajram Mehani:** Asfaltimi i rrugës Bakshi- Bardhosh
- **Arianit Zymberi:** Trotuar ne Bakshi
- **Faton Mehani:** Asfaltimi i rrugës “Sali Mehani”.
- **Bajram Mehani:** Asfaltimi i rrugës Bakshi- Bardhosh, i cili është shume i nevojshëm sepse ka mbete si pjesa me e prapambetur e Komunës se Obiliqit është 800m, dhe është rrugë publike.
- **Arianit Zymberi:** ndërtimi i trotuarit ne rrugën kryesore.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale. Dhe i ftoi të votojnë me datë 04.08.2025 në orën 19:30

Takimi përfundoi në ora 20:23 me gjithsej 17 pjesëmarrës prej tyre gra 0, burra 17

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DEFZH
Diskutim Publik

“Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028”

PROCESVERBAL

BREZNICE

Data: 29.07.2025

Ora e fillimit: 18:00

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, kryetari i këshillit të fshatit, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje të Qytetarëve, theksoi rëndësinë e planifikimit të kujdesshëm të buxhetit për të siguruar financimin e investimeve kapitale që përmirësojnë infrastrukturën, edukimin, shëndetësinë dhe cilësinë e jetës për banorët e Obiliqit. Shefi i kabinetit z. Burim Gërguri para të pranishmëve prezantoi buxhetin për vitin 2026, sipas qarkores Nr. 01/4/40, me datë 15.05.2025:

Totali i Grantit – 10,283,516.00 €

- Granti i përgjithshëm – 4,863,405.00 €
- Granti specifik për arsim – 3,980,266.00 €
- Granti specifik për shëndetësi – 1,439,845.00 €

Ligji për Obiliqin (05/L-044) – 4,600,000.00 €

Të hyrat vetanake – 1,398,314.00 €

Total Buxheti për vitin 2026 është 16,281,830.00 €

Ndarja ekonomike:

- Paga dhe mëditje – 7,075,466.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,000,000.00 €
- Shpenzime komunale – 320,000.00 €
- Subvencione dhe transfere – 1,100,000.00 €
- Investime kapitale – 5,786,364.00 €

Pas prezantimit të Buxhetimit për pjesëmarrje për vitin 2026, Shefi I kabinetit hapi debat për komente, ide dhe propozime për të pranishmit:

- **Marigona Krasnqi:** Ndertimi I rrugës “Hysen Hajdari”.
- **Burim Gërguri:** E di e di ka qenë edhe vitin e kaluar ka dikun 500m, por ka kaluar një propozim tjetër, u trajtu me zhavorr, ka ardhë rryma, ndriçimi por duhet të përfundohet gjithsesi.
- **Shkelzen Gashi:** Ndertimi I salles se educates fizike në Brezhnicë, fshati ynë ka një mungesë zhvillimi të aktiviteteve sportive, janë shumë pak. Duhët të ndërtohet sepse është dashtë të fillohet nga Breznica sepse, të gjithë janë më afër palestrës, ndërsa qytetarët e Breznicës e sidomos fëmijët sepse për të shkuar në Prishtinë duhët që prindi te humb të gjithë ditën e tij për ndonjë aktivitet sportiv. Me ndonjë leje speciale mund të organizohet edhe brenda shkollës për ndonjë event.
- **Burim Gërguri:** Është shumë projekt i madh po ta them, është diku 800-900 mijë euro, i kemi ndërtu 2 në këto dy vitet e fundit. Nëse e fusim duhët të jetë edhe në projeksionet 2027-2028, sepse po shihet një rrezik edhe të mbylljes së shkollave. Kërkesa është me vend, shpresojmë që mund t’ia arrijmë.
- **Marigona Krasnqi:** Çdo dite I ndodhe fëmijëve për kurse të shkojnë në Prishtinë ne autobus dhe prindërit ti dërgojnë e ti marrin gjë që po mundëson edhe ndërrimin e banimit, është kosto e madhe për familjet tona
- **Shkelzen Gashi:** Shkolla është pajis me kabinete, por sa I përket sportit nuk ka ardh as edhe një top.
- **Shkelzen Gashi:** Ndertimi I Trotuarit rruga “Hoxhe Brezhnica”. Trotuari tek ne eshte jetik.
- **Burim Gërguri:** Çështja e hapësirave publike, ka qenë një kërkesë për një bibliotekë kërkesa ka qenë e mirëseardhur, ish objekti ambulanta mund te kthehet ne qendër për komunitet, çka mundemi te bëjmë një vendim, që ky objekt të kthehet tek komuniteti.
- Sa i përket kursit te anglishtes është keq sepse duhet te paguajmë një profesoreshe dhe është keq nëse hapet një kurs sepse fëmijët i bijën te paguajnë dhe është jo e nevojshme të krijohen shpenzime shtesë për këtë arsye, jo ne objekt te shkollës.
- 216 parashkollor 17-18 Kozarice 3

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i

rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale. Dhe i ftoi të votojnë me datë 05.08.2025 ora 18:00.

Takimi përfundoi në ora 18:26 me gjithsej 6 pjesëmarrës prej tyre gra 4, burra 2.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



VOTIMI

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

MAZGIT I ULËT

Data: 30.07.2025

Ora e fillimit: 16:25

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, Drejtorë të drejtorive komunale, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi në pika të shkurta për Buxhetimin me pjesëmarrje, si dhe i informoj rreth mundësive për realizimin e 4 (katër) projekteve të propozuara me datë 23.07.2025, theksoi rëndësinë e votimit dhe qëllimin e këtij procesi i cili është ofrimi i mundësisë së përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Javën e kaluar ju keni zgjedhur katër projekte për të votuar.

1. Asfaltimi i rrugës “Kozmaqi”.
2. Mirëmbajtja e ndriçimit publik.
3. Asfaltimi i segmentit të rrugës “Agron Rrahmani”.
4. Rregullimi i trotuarit në rrugën “Agron Rrahmani”.

Shefi i kabinetit i sqaroj dhe rregullat e votimit:

- Votojnë personat e lokalitetit mbi 14 vjet
- Voto vetëm një herë.
- Zgjedhni vetëm një projekt
- Markoje me √ projektin e preferuar

Caktohet një komision prej tre personave, njëri ndër të cilët duhet të jetë nga qytetarët ndërsa dy të tjerë nga zyrtarët komunal me këtë përbërje:

- Bahtir Binaku
- Faton Grajcevc
- Festina Preniqi

Ftohen me emra secili nga të pranishmit që të votojnë.

Fillon numërimi i votave.

Projekti i parë: Asfaltimi i rrugës “Kozmaqi”, merr 0 vota.

Projekti i dytë: Mirëmbajtja e ndriçimit publik, merr 4 vota.

Projekti i tretë: Asfaltimi i segmentit të rrugës “Agron Rrahmani”, merr 0 vota.

Projekti i katërt: Rregullimi i trotuarit në rrugën “Agron Rrahmani”, merr 0 vota.

Të pavlefshme: 0 (zero)

Shefi i uron qytetarët për projektin i cili u votua dhe do të realizohet, dhe i falënderon për gatishmërinë për të marrë pjesë.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 16:45 me gjithsej 5 pjesëmarrës prej tyre gra 1, burra 4

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



VOTIMI

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

Dardhishtë

Data: 31.07.2025

Ora e fillimit: 18:30

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi në pika të shkurta për Buxhetimin me pjesëmarrje, si dhe i informoj rreth mundësive për realizimin e 9 (nëntë) projekteve të propozuara me datë 24.07.2025, theksoi rëndësinë e votimit dhe qëllimin e këtij procesi i cili është ofrimi i mundësisë së përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Javën e kaluar ju keni zgjedhur nëntë projekte për të votuar.

- 1.Ndërtimi i kolektorit (mbulimi i kanalit) në gjatësi prej 700 m.
- 2.Ndërtimi i segmentit të trotuarit në rrugën “Ali Maloku” (prej lagjes Tërnavë deri tek lagja Gashi).
- 3.Ndërtimi i trotuarit në rrugën “Nuhi Kelmendi”.
- 4.Mbjellja e drunjve në rrugën “Nuhi Kelmendi”.
- 5.Ndërtimi i fushës sportive dhe parkut (në lagjet: Halimaj, Fanaku, Sahiti).
- 6.Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lagjen Zeqiri.
- 7.Asfaltimi i rrugës “Hazir Merlaku”, segmenti i lagjes Dobratiqi.
- 8.Asfaltimi i rrugës “Zhitia”, segmenti i katërt (lagja Kosumi).
- 9.Asfaltimi i rrugës “Qazim Gashi”, segmenti i lagjeve (Raqi, Bytyqi, Selimi).

Shefi i kabinetit i sqaroj dhe rregullat e votimit:

- Votojnë personat e lokalitetit mbi 14 vjet
- Voto vetëm një herë.
- Zgjedhni vetëm një projekt
- Markoje me $\surd$ projektin e preferuar

Caktohet një komision prej tre personave, njëri ndër të cilët duhet të jetë nga qytetarët ndërsa dy të tjerë nga zyrtarët komunal me këtë përbërje:

- Agim Sahiti
- Faton Grajqevci
- Urim Grajqevci

Ftohen me emra secili nga të pranishmit që të votojnë.

Fillon numërimi i votave.

Projekti i parë: Ndërtimi i kolektorit (mbulimi i kanalit) në gjatësi prej 700 m, merr 4 vota.

Projekti i dytë: Ndërtimi i segmentit të trotuarit në rrugën “Ali Maloku” (prej lagjes Tërnavë deri tek lagja Gashi), merr 0 vota.

Projekti i tretë: Ndërtimi i trotuarit në rrugën “Nuhi Kelmendi”, merr 10 vota.

Projekti i katërt: Mbjellja e drunjve në rrugën “Nuhi Kelmendi”, merr 0 vota.

Projekti i pestë: Ndërtimi i fushës sportive dhe parkut (në lagjet: Halimaj, Fanaku, Sahiti), merr 2 vota.

Projekti i gjashtë: Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lagjen Zeqiri, merr 0 vota.

Projekti i shtatë: Asfaltimi i rrugës “Hazir Merlaku”, segmenti i lagjes Dobratiqi, merr 7 vote.

Projekti i tetë: Asfaltimi i rrugës “Zhitia”, segmenti i katërt (lagja Kosumi), merr 1 vote.

Projekti i nëntë: Asfaltimi i rrugës “Qazim Gashi”, segmenti i lagjeve (Raqi, Bytyqi, Selimi), merr 1 vota

Të pavlefshme: 0 (zero)

Shefi i uron qytetarët për projektin i cili u votua dhe do të realizohet, dhe i falënderon për gatishmërinë për të marrë pjesë.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 19:30 me gjithsej 26 pjesëmarrës prej tyre gra 2, burra 24.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



VOTIMI

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

SIBOC

Data: 01.08.2025

Ora e fillimit: 17:30

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi i kabinetit, z. Burim Gërguri, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi i kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi në pika të shkurta për Buxhetimin me pjesëmarrje, si dhe i informoj rreth mundësive për realizimin e 2 (dy) projekteve të propozuara me datë 25.07.2025, theksoi rëndësinë e votimit dhe qëllimin e këtij procesi i cili është ofrimi i mundësisë së përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Javën e kaluar ju keni zgjedhur dy projekte për të votuar.

1. Funksionalizimi i shtëpisë për komunitet
2. Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Sadiku

Besnik Salihu (Zyrtari kryesor financiar nw Komunwn e Obiliqit) i sqaroi dhe rregullat e votimit:

- Votojnë personat e lokalitetit mbi 14 vjet
- Voto vetëm një herë.
- Zgjedhni vetëm një projekt
- Markojë me √ projektin e preferuar

Caktohet një komision prej tre personave, njëri ndër të cilët duhet të jetë nga qytetarët ndërsa dy të tjerë nga zyrtarët komunal me këtë përbërje:

- ?
- Urim Grajqevci
- Adem Haliti

Ftohen me emra secili nga të pranishmit që të votojnë.

Fillon numërimi i votave.

Projekti i parë: Ndërrimi i gypit të ujësjellësit, merr 3 vota.

Projekti i dytë: Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Sadiku, merr 6 vota.

Të pavlefshme: 0 (zero)

Burim Gërguri i uron qytetarët për projektin i cili u votua dhe do të realizohet, dhe i falënderon për gatishmërinë për të marrë pjesë.

Në fund të takimit, Shefi i kabinetit, z. Burim Gërguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 18:00 me gjithsej 10 pjesëmarrës prej tyre gra 1, burra 9

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



VOTIMI

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

LAJTHISHTE

Data: 01.08.2025

Ora e fillimit: 18:30

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, Drejtoresha e DEFZH-së, znj. Zarife Behluli, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi në pika të shkurta për Buxhetimin me pjesëmarrje, si dhe i informoj rreth mundësive për realizimin e 4 (katër) projekteve të propozuara me datë 25.07.2025, theksoi rëndësinë e votimit dhe qëllimin e këtij procesi i cili është ofrimi i mundësisë së përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Javën e kaluar ju keni zgjedhur katër projekte për të votuar.

1. Ndërtimi i segmentit të rrugës “Sabedin Pllana”
2. Ndërtimi i rrugës “Ulpiana”
3. Ndërtimi i parkut në Lajthishtë
4. Ndërtimi i segmentit të rrugës në lagjen Kurshumlia, tek shkolla

Besnik Salihu (Zyrtari kryesor financiar në Komunën e Obiliqit) i sqaroj dhe rregullat e votimit:

- Votojnë personat e lokalitetit mbi 14 vjet
- Voto vetëm një herë.
- Zgjedhni vetëm një projekt
- Markoje me √ projektin e preferuar

Caktohet një komision prej tre personave, njëri ndër të cilët duhet të jetë nga qytetarët ndërsa dy të tjerë nga zyrtarët komunal me këtë përbërje:

- Behlul Prenku
- Faton Grajqevci
- Urim Grajqevci

Ftohen me emra secili nga të pranishmit që të votojnë.

Fillon numërimi i votave.

Votuan 7 (shtatë) qytetar,

Projekti i parë: Ndërtimi i segmentit të rrugës “Sabedin Pllana”, merr 6 vota.

Projekti i dytë: Ndërtimi i rrugës “Ulpiana”, merr 0 vota.

Projekti i tretë: Ndërtimi i parkut në Lajthishtë, merr 0 vota.

Projekti i katërt: Ndërtimi i segmentit të rrugës në lagjen Kurshumlia, tek shkolla, merr 0 vota.

Të pavlefshme: 1 (një)

Shefi i uron qytetarët për projektin i cili u votua dhe do të realizohet, dhe i falënderon për gatishmërinë për të marrë pjesë.

Në fund të takimit, Shefi i Kabinetit, z. Burim Gerguri, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre. Ai theksoi se buxhetimi në pjesëmarrje është një hap i rëndësishëm drejt transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen komunale.

Takimi përfundoi në ora 18:40 me gjithsej 7 pjesëmarrës prej tyre gra 0, burra 7.

Procesmbajtëse: Mimoza Hashani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



VOTIMI

“Buxhetimi me pjesëmarrje”

PROCESVERBAL

PALAJ

Data: 01.08.2025

Ora e fillimit: 19:30

Të pranishëm në këtë debat publik ishin: Besnik Salihu Zyrtar kryesor financiar, qytetarë, anëtarë të grupeve punuese për projektin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultime publike.

Mbledhjen e hapi Shefi I kabinetit z.Burim Gërguri, i cili para të pranishmëve prezantoi në pika të shkurta për Buxhetimin me pjesëmarrje, si dhe i informoj rreth mundësive për realizimin e 5 (pesë) projekteve të propozuara me datë 25.07.2025, theksoi rëndësinë e votimit dhe qëllimin e këtij procesi i cili është ofrimi i mundësisë së përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Javën e kaluar ju keni zgjedhur pesë projekte për të votuar.

- 1.Ndërrimi i gypit të ujësjellësit
- 2.Ndërrimi i rrjetit të kanalizimit
- 3.Rregullimi i parkingut dhe rrethojës së shkollës
- 4.Rregullimi i varrezave
- 5.Objekti i shëndetësisë të shndërrohet në shtëpi për komunitetin

Besnik Salihu (Zyrtari kryesor financiar në Komunën e Obiliqit) i sqaroi dhe rregullat e votimit:

- Votojnë personat e lokalitetit mbi 14 vjet
- Voto vetëm një herë.
- Zgjedhni vetëm një projekt
- Markoje me √ projektin e preferuar

